# PLANI OPERACIONAL

# I ZHVILLIMIT VENDOR

## BASHKIA TEPELENË

SWEDEN

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Embassy of Switzerland in Albania

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTRI PËR ÇËSHTJET VENDORE

Cooperazione Italiana allo Sviluppo
Ministero Affari Esteri
Cooperazione Internazionale

USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

UNDP
Empowered lives.
Resilient nations.

**Shkurt, 2016**

Përgatitur nga:
Akademia e Studimeve Politike

Akademia e Studimeve Politike
Adresa: Qendra Kotoni, Rr.Donika Kastrioti, Nr.3, Kati 4, Zyra 2, Tirana, Albania
Tel: +355 4 2272173, +355 44504788, web: www.asp.al

## Tabela e Përmbajtjes


1. Nevoja për një Plan Operacional për Investime 4
2. Plani operacional afatshkurtër në perspektivën e qeverisjes lokale dhe proceseve planifikuese 6
3. Metodologjia për përgatitjen e POZHL 8
4. Diagnoza 10
   *4.1 Fakte kryesore* 10
   *4.2 Zhvillimi ekonomik* 11
   *4.3 Mirëqënia ekonomike dhe sociale* 12
   *4.4 Burimet natyrore dhe qëndrueshmëria mjedisore* 13
   *4.5 Konkluzione* 14
5.Përcaktimi i problemeve dhe prioriteteve operacionale afat-shkurtra 16
6. Plani Operacional 18
7. Harta dhe fotografi 26

# 1. Nevoja për një Plan Operacional për Investime

Projekti i hartimit të Planit Operacional të Zhvillimit Lokal (POZHL) u iniciua nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore në bashkëpunim me projektin STAR, të menaxhuar nga UNDP. Projekti STAR ka ardhur si një reagim i menjëhershëm i mbështetjes që donatorë të ndryshëm ofruan për Qeverinë në përpjekjet e ndërmara për zbatimin e reformës administrative territoriale. Hartimi i POZHL rezulton si sfidë kryesore dhe nevojë imediate për të patur një plan të integruar të veprimeve dhe masave që bashkia e re duhet të marrë, për të siguruar kohezionin administrativ dhe territorial të të gjitha njësive administrative të saj, pas reformës territoriale. Sigurimi i kohezionit administrativ dhe territorial kërkon masa dhe veprime që mund të përfshijnë ristrukturimin administrativ, të shërbimeve administrative dhe shërbimeve publike, të infrastrukturës lidhëse të njësive administrative etj.

POZHL është dokumenti kryesor që do të orientojë punën, do të bashkërendojë përpjekjet e aktorëve të ndryshëm në periudhën afatshkurtër (rreth 3 vjeçare) me qëllim sigurimin e kohezionit administrativ dhe territorial të bashkive të reja.

Në rastin e Bashkisë Tepelenë, ky proces në nivel lokal u zbatua nga Akademia e Studimeve Politike (ASP). Kjo nismë synon të asistojë Bashkinë e Tepelenës në planifikimin e masave dhe veprimeve, përfshirë projektet e investimeve kapitale, për periudhën afatshkurtër (2-3 vjeçare), të integruara në POZHL.Qëllimi i këtij instrumenti konsiston në analizën e situatës aktuale, duke synuar të evidentojë fillimisht përparësitë territoriale dhe problematikat kryesore dhe më pas  prioritetet që adresojnë nevoja, në përgjigje të të cilave duhet të propozohen ndërhyrjet në formën e projekteve. Projektet e gjeneruara do të mund t'i paraqiten për financim apo bashkëfinancim Qeverisë (psh. nëpërmjet mekanizmit të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve), apo donatorëve të tjerë, si FSHZH. Për më tepër, jo të gjitha projektet do të kenë nevojë për financime nga donatorë. Plani përfshin edhe projekte të buta të cilat janë të zbatueshme nga vet bashkia, pa implikime të mëdha financiare.

Një plan i tillë është ndërtuar bazuar në tre parime: parimi gjithëpërfshirës, holistik dhe koheziv.

Parimi gjithëpërfshirës siguron që POZHL është hartuar jo vetëm bazuar në nevojat dhe specifikat e territorit, por ndërkohë ka fuqizuar aktorët kryesor lokal për të krijuar një kuptim më të mirë të situatës aktuale, përparësive dhe nevojave.

Zhvillimi koheziv orienton zhvillimin lokal në atë mënyrë që mundëson kohezionin social të bashkisë së sapo krijuar. Territoret e reja kanë nevojë për ndërhyrje publike të orientuara me qëllim nxitjen e ndërveprimeve sociale ekonomike.

Parimi holistik siguron që të gjithë faktorët influencues të zhvillimit të territorit janë marrë në konsideratë. Si rrjedhim, hartimi i POZHL është bërë bazuar në njohuri të plota të faktorëve që përcaktojnë zhvillimin e ardhshëm të bashkisë së re.

Plani operacional përfshin prioritetet operacionale dhe projektet për secilën prej tyre. Gjithashtu, për çdo projekt është përcaktuar grupi i synuar, periudha e zbatimit, vlerësimi i kostos, burimi i financimit, mënyra e zbatimit dhe ndikimi i pritur. Në vazhdim të saj, është përfshirë edhe një numër i caktuar projektfishash për projekte të caktuara.

Ky dokument ofron disa avantazhe për administratën e bashkisë:

- krijon një tablo të qartë të përparësive territoriale;
- krijon një tablo të qartë të nevojave që duhet të adresohen për zhvillimin koheziv të territorit;
- orienton dhe kanalizon vëmendjen dhe punën e administratës në prioritete zhvillimi;
- ofron një hartë që duhet të ndiqet për të përmbushur një vizion zhvillimi;
- shërben si dokument menaxhimi financiar duke ofruar kosto vlerësimi të projekteve;
- Delegon dhe ndan përgjegjësi mes aktorëve kryesore me afate të përcaktuara.

# 2. Plani operacional afatshkurtër në perspektivën e qeverisjes lokale dhe proçeseve planifikuese

Hartimi i POZHL përbën një sfidë të rëndësishme për nxitjen e zhvillimit të bashkisë gjatë 2-3 viteve në vazhdim. Aktualisht, bashkia nuk ka një plan të përgjithshëm vendor dhe strategjik mbi të cilët do të duhej të hartohet një plan operacional. Në këtë kontekst, do të duhet të ndodh e kundërta, që këto dy instrumente të bazohen në dokumentin e POZHL. Si rrjedhim, puna e realizuar për POZHL do t'i paraprijë fillimit të afërt të punës me hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Zhvillimit Strategjik. Në lidhje me proceset planifikuese që do të vijojnë në vazhdimësi gjatë 2016-tës, POZHL ofron një punë paraprake përgatitore që lehtëson proceset planifikuese, duke u ofruar të dhëna për territorin e konsoliduar të bashkisë, diagnozën duke theksuar përparësitë dhe nevojat e zhvillimit, por ajo cfarë është më e rëndësishme ofron vizionin e zhvillimit.

Artikulimi i vizionit mbart në vetvete avantazhin për të udhëhequr proceset planifikuese të zhvillimit të territorit. Siç është theksuar më sipër, një nga komponentët e POZHL është plani operacional (shih kap.6 Plani operacional), i cili përmban prioritetet operacionale, projekt idetë, grupet e synuara, periudhën e zbatimit, kostot, burimin e financimit, përgjegjësit e zbatimit dhe rezultatin e pritshëm etj

Drejtuesit e Bashkisë së Tepelenës kanë planifikuar për vitin 2016 mbi 20 projekte, kryesisht në infrastrukturë. Për një pjesë të tyre kanë filluar punimet me fondet e vetë Bashkisë. Vlerësohet, se brenda vitit të parë të mandatit të drejtuesve aktualë, pjesa më e madhe e këtyre projekteve do të kenë përfunduar. Fokusi i këtyre projekteve shtrihet jo vetëm në lagjet kryesore të qytetit të Tepelenës, por edhe në disa fshatra.

Bashkia e Tepelenës ka qenë përfituese e "thirrjes së parë" të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, me dy projekte: rikonstruksioni i sheshit kryesor të qytetit dhe hyrjes së kalasë së Tepelenës, si dhe studimi urbanistik dhe infrastruktura e zonës së spitalit. Këto investime priten të pasohen edhe nga të tjera, që do të sjellin ndryshime të prekshme në cilësinë e jetës së banorëve. Stafi drejtues i bashkisë shpreh angazhim konkret për të krijuar mundësi të reja për përmirësimin e nivelit të jetesës së qytetarëve, nëpërmjet uljes së taksave vendore, duke i konsideruar këto si masa që do të favorizojnë biznesin dhe do të sjellin rritjen e të ardhurave dhe të numrit të të punësuarve në Bashkinë e Tepelenës. Në përputhje edhe me kuadrin ligjor, në plotësim e sipër, për kompetencat që do të ketë pushteti vendor në bazë të hartës së re territoriale, këto masa do të fillojnë të jenë efektive, që në vitin e parë të mandatit të drejtuesve aktualë të bashkisë.

Hartimi i POZHL përbën gjithashtu një sfidë të rëndësishme për nxitjen e zhvillimit të bashkisë gjatë 2-3 viteve në vazhdim. Bashkisë së Tepelenës i ka munguar më herët Instrumenti i Përgjithshëm Vendor, kështu që puna e realizuar për POZHL do t'i paraprijë fillimit të afërt të punës me hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Zhvillimit Strategjik. Në draftin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar, zona e Tepelenës konsiderohet si aks potencial zhvillimi ekonomik për shkak të lokalizimit dhe burimeve natyrore.

# 3. Metodologjia për përgatitjen e POZHL

ASP ka përgatitur POZHL për Bashkinë e Tepelenës, sipas strukturës të kërkuar nga Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, të theksuar në Termat e Referencës të Projektit. Procesi i mbledhjes së të dhënave, përpunimi dhe analiza, e cila përfundon në diagnozën e situatës socio-ekonomike të zhvillimit në këtë bashki, është pjesë thelbësore e shërbimit për përgatitjen e POZHL. Bazuar në përvojat e mëparshme të vlefshme në proçese të ngjashme, APS përshati një metodologji të thjeshtë për hartimin e POZHL. Metodologjia e zbatuar për të hartuar POZHL e bashkisë Tepelenë përfshin zbatimin e aktiviteteve të mëposhtme:

1 . Sigurimi i angazhimit lokal përfshiu prezantimin e nismës te Kryetari i bashkisë dhe një pjesë të stafit kyc të bashkisë. Ky prezantim pati si qëllim jo vetëm informimin rreth nismës por edhe konfirmimin e interesit dhe angazhimit të Kryetarit dhe administratës për të qenë pjesë aktive e procesit të hartimit të POZHL.

2. Krijimi i një grupi lokal për hartimin e POZHL. Në këtë grup morën pjesë përfaqësues të zyrave kryesore të bashkisë, administratorët e njësive administrative dhe ekspertë të ndryshëm lokal.

3. Rishikimi i burimeve sekondare të informacionit përfshiu analizimin e dokumentave strategjik si plane zhvillimi lokal të ish NJQV-së pjesë e bashkisë së re, raporte e studime të ndryshme. Botimet e INSTAT, Census 2011 u përdorën gjerësisht për treguesit demografik, social dhe ekonomik. Një listë paraprake me tregues u krijua. Gjithashtu, formate të gatshme për mbledhje të dhënash u gjeneruan me qëllim lehtësimin e mbledhjes së të dhënave nga grupi lokal.

4. Mbledhja e të dhënave më ndihmën e grupit lokal, takime të ndryshme në nivel lokal, rajonal dhe qendror u realizuan për të përftuar të dhënat për analizën e situatës.

5. Analizimi i të dhënave dhe realizimi i diagnozës. Ky aktivitet përfshiu sintetizimin e gjithë të dhënave të mbledhura për përdorim të mirë të të dhënave në fazat vijuese. Pas analizës së tyre dhe përftimit të situatës aktuale (pjesë e së cilës ishte edhe gjenerimi i pemës së problemeve) vizionimi erdhi si hap i natyrshëm i asaj që zhvillimi koheziv duhet të sjellë në të ardhmen.

6. Prioritet operacionale. Diagrama e pemës së problemeve dhe më pas ajo e objektivave ishin instrumente të rëndësishme për të përcaktuar prioritetet operacionale. Lista e përparësive të identifikuara të territorit shërbeu si ndihmë në përcaktimin e plotë të tyre.

7. Plani i veprimit. Në përputhje me prioritetet operacionale të identifikuara u gjeneruan

projektet konkrete që do të përmbushin arritjen e prioriteteve. Platforma elektorale e kryetarit u përdor së bashku me të tjera dokumente të mëparshme pune në identifikimin e projekteve. Puna më tej përfshiu identifikimin e detajeve që lidhen me koston, grupin e synuar, aktorë përgjegjës dhe rezultati i pritshëm për çdo projekt.

8. Konsultimi rreth ecurisë kryesore të planit, prioriteveve dhe projekteve konkrete.

9. Shkrimi i planit dhe finalizimi në dokumentin e POZHL.

# 4. Diagnoza

## *4.1 Fakte kryesore*

Bashkia Tepelenë kufizohet në veri me bashkinë Memaliaj, në lindje me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Gjirokastër dhe në perëndim me bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Tepelenës. Në përbërje të kësaj bashkie ndodhen 4 njësi administrative: Tepelenë, Qendër Tepelenë, Lopës dhe Kurvelesh, ndërsa fshatrat në përbërje të tyre janë si në vijim:

- Qendër Tepelenë: Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezhgoran, Peshtan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat
- Lopës: Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmblan, Lab Martalloz
- Kurvelesh: Progonat, Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhin

### POPULLSIA

Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 8.949 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 16.371 banorë. Diferenca e madhe ndërmjet këtyre shifrave mund të shpjegohet me lëvizjen migratore, që për këtë zonë ka patur përpjestime mjaft të mëdha, të pareflektuar ende në rregjistrat e gjendjes civile. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 431.24 km2 me një densitet prej 12.1 banorë/km2 (disafish më e ulët se mesatarja në rang vendi, për shkak të sipërfaqes së madhe me zonë malore).

Të dhënat aktuale të vitit 2015 flasin për një numër total prej 16,4 mijë banorësh të rregjistruar në gjendjen civile, krahasuar me rreth 20 mijë në vitin 2000. Duket se rënia sistematike e numrit të popullsisë aktualisht është frenuar, si në territorin e ish-komunave, ashtu edhe në qytetin e Tepelenës. Njohja e kësaj dinamike dhe parashikimi për vitet në vijim do të jenë një variabël bazë për planifikimin e ardhshëm strategjik.

Raporti gjinor, sipas të dhënave të censusit të vitit 2011 rezulton të jetë 104.9, pak më i lartë se mesatarja kombëtare prej 100.4, gjë që mund të shpjegohet me fenomenin më të lartë të migrimit tek gjinia femërore.

Në Bashkinë e Tepelenës, grupmosha 15 – 64 vjeç përbën 66.9 % të totalit të banorëve, duke qenë thuajse afër mesatares kombëtare (68%), po ashtu si edhe grupmosha e fëmijeve: 19% (mesatarja në rang vendi 20%).

Dinamika e popullsisë: sipas të dhënave demografike të marra nga gjendja civile e Bashkisë së Tepelenës, popullsia është zvogëluar me gati 16% në periudhën 2000-2015. Gjatë pesë viteve të fundit rënia e popullsisë ka vazhduar gati me të njëjtat ritme. Emigrimi ka qënë kryesisht jashtë shtetit, por edhe drejt qyteteve të tjera të Shqipërisë (Sarandë, Tiranë etj). Kthimi i emigrantëve deri në vitin 2011 ka qenë i papërfillshëm, rreth 400 persona gjithsej, (0.3% e totalit të emigrantëve të kthyer).

### Punësimi

Papunësia në Bashkinë e Tepelenës rezulton në nivele të larta: rreth 37%. Shkalla e papunësisë për bashkinë paraqitet më e lartë se mesatarja e papunësisë në rang vendi (rreth 30%). Indeksi i papunësisë për të rinjtë (mosha 15-24 vjec) dhe për femra paraqiten gjithashtu më të larta se mesatarja e vendit. Respektivisht, norma e papunësisë për të rinjtë është 67.3% (mesatarja kombëtare: 52.9%), ndërsa norma e papunësisë për femrat është 41.8% (mesatarja kombëtare 31.4%). Këta tregues flasin për domosdoshmërinë e marrjes së masave urgjente, nëpërmjet projekteve, që synojnë rritjen e numrit të të punësuarve, pa lënë jashtë vëmendjes edhe fuqizimin e orientimin nga tregu i punës të arsimit profesional të mesëm.

Për shkak të natyrës mikse të ekonomisë lokale, banorët janë të punësuar në sektorë të ndryshëm si bujqësi, industri dhe shërbime. Struktura e punësimit në këto sektorë paraqitet si më poshtë: në bujqësi janë të punësuar 26% e forcës aktive të punës, në industri rreth 14%, dhe në shërbime 60%. Këta tregues flasin për një strukturë konomike me natyrë urbane, duke u larguar gjithmonë e më tepër nga karakteristikat e dikurshme rurale të zonës.

## *4.2 Zhvillimi ekonomik*

Ekonomia e Bashkisë së Tepelenës karakterizohet nga prezenca e informalitetit dhe mbizotërimi i bizneseve të vogla dhe familjare. Numërohen në total rreth 353 biznese, nga të cilat pjesa më e madhe e zhvillojnë aktivitetin në territorin e njësisë administrative Tepelenë. Tregtia dhe shërbimet përqendrojnë mbi gjysmën e aktiviteteve të biznesit në total.

Sektori i shërbimeve është më i zhvilluari, ai është përgjegjëse për gati gjysmën e outputit dhe punësimit. Rritmi i rritjes së ketij sektori ka qenë konstant edhe gjatë 4-5 viteve të fundit me një normë mesatare prej 1-2% në vit. Rritja e shpejtë e këtij sektori është e lidhur ngushtë me shfrytëzimin e potencialeve turistike që ka bashkia. Atëherë, shërbimet mund të luajnë rolin e motorrit të rritjes eknomike në vitet në vazhdim.

Krahas sektorit të shërbimeve, po tenton të rritet gradualisht aktiviteti me natyrë industriale, që konsiston në bizneset e industrisë së lehtë dhe ushqimore (Uji Tepelena), por edhe përpunimin fillestar të bimëve medicinale.

Rënia e interesit ndaj zhvillimi të aktiviteteve tradicionale të bujqësisë është e dukshme,

diçka më mirë paraqitet prodhimi blegtoral nga baxhot e zonës. Aktivitetet ekszituese bujqësore synojnë më tepër përmbushjen vetëm të nevojave familjare dhe janë të kufizuara në përdorimin e ngastrave jo më të madhe se 1-2 ha për këtë qëllim. Klima e përshtatshme lejon rritjen e rreth 41 mijë rrënjë ullinj dhe 38 mijë rrënjë hardhi. Në fermat blegtorale rriten rreth 70 mijë krerë të imta (50 mijë dele dhe 20 mijë dhi) dhe 4 mijë gjedhë, produktet e të cilave tregtohen edhe jashtë territorit të bashkisë.

Një investim, që ia vlen të përmendet, është ai i biznesit të kultivimit të peshkut, i ndërtuar në brigjet e lumit Vjosë, në afërsi të urës së Hormovës. Kjo tentativë mund të pasohet nga të tjera, që synojnë të shfrytëzojnë pasuritë ujore të bashkisë.

### *4.3 Mirëqenia ekonomike dhe sociale*

Nga shqyrtimi i burimeve të të ardhurave familjare, rezulton se ndihma sociale dhe përfitimet të ngjashme me të zënë 12% të të ardhurave familjare për popullatën lokale të Tepelenës. Në një nivel dy herë më të ulët paraqiten remitancat, që përfaqësojnë 6% të të ardhurave. Ndërkohë, burimi kryesor i të ardhurave familjare janë punësimi dhe vetpunësimi, që së bashku përfaqësojnë më shumë se gjysmën e totalit: 53%, si dhe llojet e ndryshme të pensioneve: gati 30% (kjo e fundit tregon përbërjen e moshuar të popullsisë së zonës).

Të dhënat mbi numrin e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike janë një tregues indirekt i nivelit të varfërisë në Bashkinë e Tepelenës. Këtë ndihmë e përfitojnë në total rreth 400 familje, nga të cilat 180 në qytetin e Tepelenës. Në raport me numrin total të familjeve, rezulton se në Bashkinë e Tepelenës përfitojnë ndihmë ekonomike rreth 15,2 % e familjeve. Përqindja mbetet thuajse konstante dhe nuk ka patur reduktime të ndjeshme gjatë viteve të fundit.

Furnizimi me ujë të pijshëm vazhdon të mbetet një nga problemet më të rëndësishme infrastrukturore, pasi jo më shumë se 54% e banorëve të Bashkisë së Tepelenës (54% në qytet dhe 58% në zonat rurale) kanë akses në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Furnizimi me ujë të pijshëm garantohet për rreth 15 orë në ditë. Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve të Tepelenës ka mundësi mjaft të vogla për investime, madje herë pas here gjendet në prag të falimentimit, për shkak të detyrimeve të papaguara nga institucionet shtetërore. Investimi më i rëndësisht aktualisht, është ai në ujësjellësin e fshatit Dukaj, që synon të përmirësojë furnizimin me ujë në njësinë administrative Qendër Tepelenë. Treguesit e deritanishëm mbeten larg nivelit që do të mundësonte jetesën me standarte të pranueshme higjeno-sanitare për banorët e zonës.

Në veçanti e rënduar është situata e grave dhe vajzave në këtë bashki, të cilat përballojnë më së shumti sjelljen e ujit në shtëpi, apo merren me pastrimin, larjen e rrobave etj.

Duhet theksuar progresi lidhur me formalizimin dhe përmirësimin e furnizimit me energji elektrike të banorëve. Brenda dy viteve të fundit u arrit që 99% e konsumatorëve të pajisen me kontrata e matësa të energjisë elektrike, ndërsa aktualisht vazhdon shlyerja sistematike e detyrimeve të prapambetura ndal OSHEE. Komuniteti ka reagur pozitivisht ndaj këtij proçesi, por theksohet se kamatvonesat përbëjnë një barrë të vështirë  për buxhetet familjare dhe shpesh kërkohet falja e tyre.

Infrastruktura rrugore e Bashkisë se Tepelenës u përmirësua ndjeshëm me përfundimin e ndërtimit të akseve rrugore Tepelenë – Gjirokastër dhe Fier – Tepelenë, duke e bërë këtë

bashki pjesë të tranzitit kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve. Problem mbetet lidhja rrugore e qendrave të njësive administrative me qytetin e Tepelenës, veçanërisht për Kurveleshin (18 km) dhe Lopësin (21 km).

Bashkia e Tepelenës është e lidhur me linja të transportit publik me kryeqytetin dhe qytetet e afërta. Përjashtim bën transporti i rregullt me qytetin e Memaliajt, ku një linjë e tillë mungon dhe transporti kryhet nga mjete të rastit, pa orar të përcaktuar. Kjo krijon në veçanti kosto të tepërta dhe humbje kohe për gratë dhe vajzat që përdorin më tepër këtë lloj transporti.

Bashkia e Tepelenës numëron 32 qendra shëndetësore primare, nga të cilat 14 ndodhen në njësinë administrative Qendër Tepelenë (për shkak të numrit më të madh të fshatrave). Në përbërje të këtyre qendrave ka mjekë të familjes, ndërsa disa prej tyre kanë edhe mjekë specialistë, konsulentë për gratë dhe fëmijët, si dhe staf mbështetës. Konstatohet se një pjesë e madhe e banorëve të kësaj bashkie, i drejtohet spitalit të Gjirokastrës apo atyre të kryeqytetit, për të marrë kujdes shëndetësor më të specializuar.

Në Bashkinë e Tepelenës ndodhen 41 institucione arsimore shtetërore, nga këto 16 kopshte, 24 shkolla 9-vjeçare dhe 1 shkollë e mesme. Bashkisë i nevojitet si prioritare një shkolle e re e mesme për të lehtësuar shkollën aktuale dhe për të garantuar standarte më të mira të mësimdhënies. Për shkak të varfërisë dhe problemeve infrastrukturore konstatohet frekuentim jo i rregullt i mësimit dhe në disa raste braktisja e shkollës, si tek vajzat, ashtu edhe tek djemtë.

Lidhur me zhvillimin e kulturës dhe sportit konstatohet pamjaftueshmëri objektesh. Në këtë bashki ndodhet vetëm një qendër social-kulturore dhe një sportive. Këto të fundit plotësohen disi nga objekte private, kryesisht minifutbolli. Investimet në objekte me natyrë social-kulturore dhe sportive mbeten një prej prioriteteve të bashkisë.

Në Bashkinë e Tepelenës totali i personave me aftësi të kufizuar përbën 8.8% të totalit të banoreve, gjë që renditet mbi mesataren kombëtare (rreth 6%). Kjo shifër flet për gadishmëri më të ulët për punë dhe aktivitetet të tjera shoqërore, krahasuar me zona të tjera të vendit.

Numri i familjeve që kanë kryefamiljare femra në Bashkinë e Tepelenës përfaqëson rreth 15.1 % të familjeve, tregues që është pak mbi mesataren e vendit, prej 14.2% dhe dëshmon pjesërisht edhe për ndryshimet në marrdhëniet familjare, të ndodhura gjatë viteve të fundit.

## *4.4 Burimet natyrore dhe qëndrueshmëria mjedisore*

Ujërat sipërfaqësore përfaqësohen nga ato te lumit Vjosa dhe të degëve të tij (Drino-Bençe-Luftinje). Ujërat nëntokësore përfaqësohen nga burimet masive karstike si Uji i Ftohtë Tepelenë, Hormova, Lekel, Bença, Gurra në Progonat, Bambulli në Dukaj.

Bashkia e Tepelenës është e pasur me bimësi, si në lloje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve, qe shtrihet deri ne lartësinë 600-800 metra, brezi i dushkut 800-1200 metra, pyjet fletëgjere, halore e të përzier dhe deri në kullotat alpine me lartësi mbi 1000 m.

Bashkisë së Tepelenës, natyra i ka dhuruar një peisazh të larmishëm gjeografik, që krijon potencial turistik. Përveç maleve, kodrinave, fushave, luginave, lumenjve, ujvarave, kanioneve, honeve, pasurive nëntokësore dhe ato botanike e shtazore, ky territor është i pasur dhe me një numër të konsiderueshëm shpellash te cilat jane me shume interes për tu eksploruar, si nga vendasit dhe të huajt.

Territori i Bashkisë së Tepelenës ofron bukuri natyrore (Lugina e Bençes, Uji i Ftohtë, disa gryka  malesh dhe lumenjsh), mundësi të mëdha për të apasionuariti e alpinizmit, kajakut, spelologjise, apo shëtitjeve malore. Gjithashtu ka një numër objektesh arkeologjike të periudhës ilire (ndërtime të fisit epiriot të kaonëve) dhe të epokave më të vonshme. Vend të posaçëm në trashëgiminë historike-kulturore zë padyshim kalaja e Ali Pashë Tepelenës. Gjatë viteve të fundit janë bërë përpjekje nga bashkia për ta sistemuar e pastruar terrenin e kalasë, por nevojiten ende investime për ta kthyer atë në një objekt të vizitueshëm e tërheqës për turistët. Të gjitha këto, të bashkuara me mikpritjen tipike të Labërisë, i japin Tepelenës nje potencial të konsiderueshëm turistik, edhe nga këndvështrimi i POZHL.

Megjithatë, Bashkisë së Tepelenës i duhet të përballet me probleme mjedisore, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve të ngurta, riciklimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra etj. Vlen të përmendet progresi i konstatuar gjatë dy viteve të fundit, me shtimin e numrit të kontenerëve për mbetjet, rregullsinë në tërheqjen e tyre, si dhe zhvillimin e një sërë aktivitetesh për edukimin mjedisor.

## *4.5 Konkluzione*

Nga sa u trajtua në pikat e mësipërme, mund të formulohen konkluzionet e mëposhtme, lidhur me Bashkinë e Tepelenës:

- Numri i popullsisë vazhdon të ulet, por ritmi duket se është frenuar disi. Emigrimi për shkak të kushteve të vështira të jetesës që parashikohet të vazhdojë, prek kryesisht moshat e reja dhe ndërthuret edhe me synimin për arsimim të mëtejshëm. Bashkisë do t'i duhet të ndërmarrë inisiativa komplekse për frenimin e largimit të pjesës më vitale të popullsisë.
- Papunësia e lartë mbetet një shqetësim konstant. Duket se tregu lokal i punës, por edhe ai i qyteteve më të afërta (Gjirokastra, Saranda, Vlora etj.), apo i kryeqytetit nuk ofron mundësi punësimi proporcionalisht me numrin e banorëve. Nga ana tjetër, niveli arsimor dhe aftësitë e punëkërkuesve shpesh mund të mos përkojnë me pritshmëritë e tregut.
- Dinamika më e lartë e zhvillimit të biznesit vërehet në sektorin e shërbimeve, ku janë hapur disa qindra vende pune, duke u mbështetur tek biznesi familjar, që siguron pjesën më të madhe të punësimit dhe të ardhurave. Angazhimi në blegtori ka një tendencë të lehtë rritëse, ndërsa së fundi po bëhen përpjekje për të tërhequr në këtë zonë disa biznese fasonesh, që mund të ofrojnë një numër të madh vendesh pune, kryesisht për gratë e vajzat.
- Sipërfaqja e tokës bujqësore mbetet konstante, ndërsa prodhimi bujqësor është i orientuar më tepër nga plotësim i nevojave të veta familjare dhe ato të blegtorisë.
- Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet ende nuk mbulojnë më tepër se gjysmën e totalit të banorëve, kjo mbetet një nga sfidat e vështira për t'u përballuar në vitet në vazhdim.
- Infrastruktura rrugore ka njohur përmirësime nga viti në vit, por ende janë të paasfaltuara rreth 60% e rrugëve, sidomos në zonën rurale. Problem mbetet shtimi i numrit të urave të vogla dhe riparimi i atyre egzistuese.
- Transporti publik ndërqytetës funksionon rregullisht me qytete e largëta, por nuk

ka një linjë të përhershme, me orare të caktura drejt qytetit më të afërt të Memaliajt.

- Objektet arsimore dhe shëndetësore mbulojnë pjesërisht nevojat e popullatës për këto shërbime dhe janë në limite të kapaciteteve të tyre. Nevojiten investime për godina të reja dhe riparime të atyre egzistuese në të dy sektorët. Sfidë mbetet frekuentimi jo i rregullt i shkollës, apo braktisja, nga një pjesë e fëmijëve.
- Jeta kulturore-sportive është realitivisht e varfër, për shkak të mungesës së objekteve për këtë qëllim. Tradita e këngës polifonike vazhdon të mbijetojë falë pasionit të individëve dhe grupeve lokale. Ajo përbën një vlerë unikale për identitetin e zonës dhe shton potencialin e saj turistik.
- Peisazhi natyror përbën potencial të madh turistik, ende të pashfrytëzuar. Zona ka gjithashtu objekte me vlera historike, ku vendin e kryesor e zë kalaja e Ali Pashë Tepelenës, por nuk mungojnë edhe objektet arkeologjike.
- Menaxhimi i mbetjeve ka shënuar progres lidhur me grumbullimin dhe tërheqjen e rregullt të tyre, por mbetet sfida e zgjidhjes së menaximit të integruar dhe utilizimit të tyre.

# 5. Përcaktimi i problemeve dhe prioriteteve operacionale afatshkurtra

Duke marrë në konsideratë se pjesa më e madhe e popullsisë, gati 50%, është e përqëndruar në qendrën e Bashkisë së Tepelenës, administrata do të jetë përballë vendimesh shumë të vështira për investime/apo shtrirjen e shërbimeve publike në të gjithë territorin e bashkisë. Për të mënjanuar këtë rrezik, duhen përdorur kritere në përzgjedhjen e investimeve, të tilla si: a) urgjenca për investimin; b) niveli i asksesit në shërbimet publike; c) ndikimi i investimit/shërbimit në rritjen e kohezionit në territor, etj.

Do të ishte më mirë, që investimet dhe shërbimet publike të orientohen fillimisht në qendrat e njësive administrative, dhe kriteri i urgjencës të ishtë udhëzuesi për investimet në njësitë dministrative periferike të bashkisë, ku popullsia e vogël është e shpërndarë në një numër të madh të fshatrave. Duke forcuar shërbimet publike në qendër të njësive administrative nga njëra anë, nga ana tjetër duhet të rritet aksesi i banorëve që jetojnë përreth qendrës administrative për të siguruar këto shërbime.

Për shkak të nevojave ende të paplotësuara, zhvillimi i infrastrukturës së duhur për ujësjellës, kanalizime, rrugë, sheshe publike e gjelbërim, si dhe ndërtimi i shkollave, kopshteve, çerdheve e qendrave shëndetësore përbëjnë prioritetet kryesore të Bashkisë së Tepelenës.

- Krijimi i lidhjeve më të përshtatshme të transportit publik me Bashkinë e Tepelenës, është nevojë imediate e komunitetit. Po ashtu shtimi i numrit të urave të vogla dhe riparimi i atyre aktuale.
- Investimi në kalanë e Tepelenës duhet konsideruar si prioritar, për të vendosur në efiçencë një prej pasurive më të mëdha historike të zonës. Po ashtu, edhe krijimi i kushteve më të favorshme për turizmin malor.
- Pastrimi nga mbetjet urbane dhe shtimi i hapësirave të gjelbra, sidomos brenda qytetit të Tepelenës duhet të jetë gjithashtu një prioritet.
- Distanca e konsiderueshme, në shumë raste, nga shtëpitë te shkollat e zonës, kanë rezultuar në frekuentim të çrregullt, apo braktisje të shkollave nga një pjesë e fëmijëve. Ky problem duhet të adresohet gjithashtu me prioritet.

***Vizioni***

*Bashkia e Tepelenës e ndodhur përgjatë një aksi të rëndësishëm me potencial zhvillimi, do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm social ekonomik të territorit bazuar në zhvillimin e agro-turizmit dhe turizmin alternativ, bujqësinë dhe agrobiznesin duke marë avantazh nga përparësitë territoriale dhe trashëgimia historiko-kulturore, nëpërmjet përdorimit të instrumentit të bashkëpunimit ndërvendor. Bashkia e Tepelenës, me një qeverisje të mirë lokale do të kthehet në bashki me shërbime publike cilësore dhe infrastrukturë bashkëkohore që mundëson cilësi të lartë jetese për banorët duke ngjallur te popullsia e larguar nga zonat rurale dëshirën për t'u kthyer e jetuar më mirë.*

# 6. Plani Operacional

***Nga sa u analizua më sipër, mund të renditen disa objektiva specifikë të Planit***

Operacional për Bashkinë e Tepelenës:

1. Zgjerim i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve
2. Rikonstruksioni i rrugës së Kurveleshit
3. Rikonstruksoni i rrugës së Lopësit
4. Zbatimi i projektit për gjimnazin "Abaz Shehu"
5. Rikonstruksion i qendrave arsimore dhe shëndetësore
6. Rikonstruksion i infrastrukturës së brendshme rrugore në qytetin e Tepelenës
7. Transporti i fëmijëve në shkolla
8. Analizë e nevojave për trajnim dhe organizim trajnimesh për stafin e Bashkisë Tepelenë
9. Ndërtim i një qendre social-kulturore
10. Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane dhe riciklimi

Në vijim janë paraqitur fishat e projekteve respektive:

| Titulli/Emertimi i Projektit | 1. Zgjerim i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim infrastrukture |
| Vendndodhja e projektit | Qyteti i Tepelenës |
| Buxheti total i projektit | 2 mln Eur (mund të ndahet në disa faza) |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 0.1 - 0.2%. |
| Pershkrimi i projektit | Argumentimi i projektit gjendet në pjesën e analizës së PLOZH. Megjithë projektet e zbatuara deri tani, ende nuk ka rrjet ujësjellësi dhe kanalizimesh për më tepër se për 55% të banorëve të bashkisë. Shtrirja e mëtejshme e rrjetit përbën emergjencë |
| Qellimi dhe objektivat | Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe i kanalizimeve për lagjet e qytetit të Tepelenës. |
| Rezultatet e pritshme | Nga realizim i projektit rritet niveli i kushteve higjeno-sanitare dhe përmirësohet niveli i jetesës për 4 mijë banorë të Bashkisë së Tepelenës. |
| Rendi prioritar | 1 |
| Qendrueshmeria e projektit | Menaxhimi dhe mirëmbajtja do të kryhet nga Ujësjellës Kanalizime Tepelenë sh.a. |
| Aktivitetet e projektit | Shtrim rrjeti ujësjellësi dhe kanalizimesh në lagjet e qytetit. Kohëzgjatja 2-3 vjet (me faza). |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | - |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti egziston si koncept. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është pjesë e planeve të investimeve kapitale të Bashkisë së Tepelenës |

| Titulli/Emertimi i Projektit | 2. Rikonstruksioni i rrugës së Kurveleshit |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim infrastrukture |
| Vendndodhja e projektit | Aksi rrugor Tepelenë-Kurvelesh 18 km |
| Buxheti total i projektit | 18 mln Eur (me ndarje në faza) |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 0.1 – 0.2 % |
| Pershkrimi i projektit | Kjo rrugë i nevojitet për lëvizje një numri të konsiderueshëm banorësh, për qëllime pune dhe biznesi, por edhe të rinjve e fëmijëve për lehtësuar aksesin në qytetin e Tepelenës. |
| Qellimi dhe objektivat | Rehabilitim i plotë i rrugës, me parametra bashkëkohorë . |
| Rezultatet e pritshme | Nga zbatimi i ketij projekti përfitojnë rreth 500-600 familje, të cilëve iu lehtësohet aksesi për lëvizje pune dhe biznesi, apo për frekuentimin e institucioneve arsimore. Rrit ndjeshëm sigurinë e lëvizjes në këtë segment (trotuare, ndriçim etj.) dhe përmirëson cilësinë e jetesës së komunitetit. Krijon premisa për zhvillimin e turizmit malor. |
| Rendi prioritar | 2 |
| Qendrueshmeria e projektit | Kostoja e mirëmbajtjes dhe menaxhimit do të përballohet nga Bashkia e Tepelenës. |

| | |
|---|---|
| Aktivitetet e projektit | Kohëzgjatja rreth 3 vjet. |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Ndikon pozitivisht në rritjen e shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve, duke pakësuar ndotjen nga gazrat. Regullon kullimin e ujrave në këtë segment. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është si koncept ide. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është pjesë e planeve të investimeve kapitale të Bashkisë së Tepelenës |

| **Titulli/Emertimi i Projektit** | **3. Rikonstruksioni i rrugës së Lopësit** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim infrastrukture |
| Vendndodhja e projektit | Aksi rrugor Tepelenë-Lopës 21 km |
| Buxheti total i projektit | 20 mln Eur (me ndarje në faza) |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 0.1 – 0.2 % |
| Pershkrimi i projektit | Kjo rrugë i nevojitet për lëvizje një numri të konsiderueshëm banorësh, për qëllime pune dhe biznesi, por edhe të rinjve e fëmijëve për lehtësuar aksesin në qytetin e Tepelenës. |
| Qellimi dhe objektivat | Rehabilitim i plotë i rrugës, me parametra bashkëkohorë . |
| Rezultatet e pritshme | Nga zbatimi i ketij projekti përfitojnë rreth 400-500 familje, të cilëve iu lehtësohet aksesi për lëvizje pune dhe biznesi, apo për frekuentimin e institucioneve arsimore. Rrit ndjeshëm sigurinë e lëvizjes në këtë segment (trotuare, ndriçim etj.) dhe përmirëson cilësinë e jetesës së komunitetit. Krijon premisa për zhvillimin e turizmit malor. |
| Rendi prioritar | 2 |
| Qendrueshmeria e projektit | Kostoja e mirëmbajtjes dhe menaxhimit do të përballohet nga Bashkia e Tepelenës. |
| Aktivitetet e projektit | Kohëzgjatja rreth 3 vjet. |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Ndikon pozitivisht në rritjen e shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve, duke pakësuar ndotjen nga gazrat. Rregullon kullimin e ujrave në këtë segment. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është si koncept ide. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është pjesë e planeve të investimeve kapitale të Bashkisë së Tepelenës |

| Titulli/Emertimi i Projektit | 4. **Rikonstruksioni i gjimnazit "Abaz Shehu" Tepelenë** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim infrastrukture arsimore |
| Vendndodhja e projektit | Tepelenë |
| Buxheti total i projektit | 1,2 mln Eur |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 0.5 %. |
| Pershkrimi i projektit | Egziston nevoja urgjente e rindërtimit të kësaj shkolle, për shkak të mbipopullimit dhe amortizimit të gjimnazit egzistues, si dhe vështirësive të rrugëtimit të nxënësve nga banesat e tyre. |
| Qellimi dhe objektivat | Përmirësimi i aksesit në arsimin e mesëm, për një zonë të lënë pa mbulim deri tani. Garantimi i jetës dhe shëndetit të fëmijëve, rritja e konfortit të mësimit. |
| Rezultatet e pritshme | Nga zbatimi i këtij projekti përfitojnë disa qindra nxënës, të cilët do të kenë mundësi ta zhvillojnë mësimin në kushte më komode, më pranë banesave të tyre. |
| Rendi prioritar | 3 |
| Qendrueshmeria e projektit | Mirëmbajtja dhe menaxhimi i godinës do të kryehet nga Bashkia e Tepelenës. |
| Aktivitetet e projektit | Kohëzgjatja e zbatimit të projektit: 1,5 -2 vjet. |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Nuk parashikohet të ketë efekte negative në mjedis. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti është gati. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është pjesë e planeve të investimeve kapitale të Bashkisë së Tepelenës |

| Titulli/Emertimi i Projektit | 5. **Rikonstruksion i objekteve arsimore dhe shëndetesore** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim shërbimesh publike |
| Vendndodhja e projektit | Njësitë administrative të Bashkisë Tepelenë |
| Buxheti total i projektit | 3 mln Eur (me ndarje në faza) |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 0.1 – 0.2 % |
| Pershkrimi i projektit | Shumë objekte janë të amortizuara dhe nuk plotësojnë standartet për arsim dhe kujdes shëndetësor dinjitoz. Objektet egzistuese punojnë mbi kapacitete e tyre. |
| Qellimi dhe objektivat | Rehabilitim i plotë i objekteve, në ndonjë rast ndërtim i ri. |

| | |
|---|---|
| Rezultatet e pritshme | Nga zbatimi i ketij projekti përfitojnë rreth 3 mijë familje, të cilëve iu lehtësohet aksesi në shërbime arsimore dhe shëndetësore. Lehtësohet spitali dhe shkollat e Tepelenës. |
| Rendi prioritar | 2 |
| Qendrueshmeria e projektit | Kostoja e mirëmbajtjes dhe menaxhimit do të përballohet nga Bashkia e Tepelenës. |
| Aktivitetet e projektit | Kohëzgjatja rreth 3 vjet. |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Ndikon pozitivisht në përmirësimin e shëndetit të popullatës dhe nivelin arsimor. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projektet janë si koncept ide. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projektet janë pjesë e planeve të investimeve kapitale të Bashkisë së Tepelenës. |

| **Titulli/Emertimi i Projektit** | 6. **Rikonstruksioni i rrugëve të qytetit të Tepelenës** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim infrastrukture |
| Vendndodhja e projektit | Qyteti i Tepelenës |
| Buxheti total i projektit | 10 mln Eur (me ndarje në faza) |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 0.1 – 0.2 % |
| Pershkrimi i projektit | Kjo rrugë i nevojitet për lëvizje një numri të konsiderueshëm banorësh, për qëllime pune dhe biznesi, por edhe të rinjve e fëmijëve për lehtësuar aksesin brenda qytetit të Tepelenës. |
| Qellimi dhe objektivat | Rehabilitim i plotë i rrugëve, me parametra bashkëkohorë, me kullim uji, trotuarë e ndriçim. |
| Rezultatet e pritshme | Nga zbatimi i ketij projekti përfitojnë rreth 2500 familje, të cilëve iu lehtësohet aksesi për lëvizje pune dhe biznesi, apo për frekuentimin e institucioneve arsimore. Rrit ndjeshëm sigurinë e lëvizjes në këto segmente dhe përmirëson cilësinë e jetesës së komunitetit. Krijon premisa për zhvillimin e turizmit në qytet. |
| Rendi prioritar | 2 |
| Qendrueshmeria e projektit | Kostoja e mirëmbajtjes dhe menaxhimit do të përballohet nga Bashkia e Tepelenës. |
| Aktivitetet e projektit | Kohëzgjatja rreth 3 vjet. |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Ndikon pozitivisht në rritjen e shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve, duke pakësuar ndotjen nga gazrat. Regullon kullimin e ujrave në këto segmente. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Disa projekte janë gati. |

| | |
|---|---|
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është pjesë e planeve të investimeve kapitale të Bashkisë së Tepelenës |

| Titulli/Emertimi i Projektit | 7. Transporti i fëmijëve në shkolla |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim shërbimi publik |
| Vendndodhja e projektit | I gjithë territori i Bashkisë së Tepelenës |
| Buxheti total i projektit | 300 mijë Eur |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 5 %. |
| Pershkrimi i projektit | Frekuentimi i rregullt i shkollës nga fëmijët pengohet shpesh nga largësia e vendbanimit. Transporti duhet të përfshijë të gjithë fëmijët që banojnë më larg se 2 km nga shkolla. |
| Qellimi dhe objektivat | Mundësimi i frekuentimit të rregullt të shkollës, nëpërmjet transportit me autobuzë të vegjël / furgona, për fëmijët që banojnë larg shkollës. |
| Rezultatet e pritshme | Nga zbatimi i këtij projekti mund të përfitojnë 600-700 fëmijë, të cilëve do t'iu përmirësohet rrugëtimi për në shkollë, duke mbrojtur më mire shëndetin e tyre dhe duke rritur konfortin. |
| Rendi prioritar | 3 |
| Qendrueshmeria e projektit | Mirëmbajtja dhe menaxhimi i automjeteve do të kryhet nga Bashkia e Tepelenës. |
| Aktivitetet e projektit | Transporti i fëmijëve për në shkollë (mbi 2 km nga banesa) duhet të kthehet në një shërbim publik i vazhdueshëm në kohë. |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Mund të rrisë minimalisht emetimin e gazrave të makinave dhe nivelin e zhurmës. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Projekti ndodhet në fazën e konceptimit. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti ka lindur jashtë kuadrit egzistues të planeve të mëparshme. |

| Titulli/Emertimi i Projektit | 8. Analizë e nevojave për trajnim dhe organizim trajnimesh për stafin e Bashkisë Tepelenë |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim administrativ-menaxherial |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia e Tepelenës |
| Buxheti total i projektit | 180 mijë Eur |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 8 %. |
| Pershkrimi i projektit | Është evidente nevoja për rritjen e kapaciteteve të stafit të bashkisë, në kontekstin e zhvillimeve të reja të reformës administrative-territoriale dhe funksioneve të reja që do të ushtrojë pushteti vendor. |

| | |
|---|---|
| Qellimi dhe objektivat | Analiza e nevojave për trajnim, e zhvillur në mënyrë profesionale, duhet t'i paraprijë planifikimit dhe organizimit të trajnimeve për stafin. Për çdo pozicion pune duhet të kryhet analiza e punës dhe rishikimi e plotësimi i përshkrimeve të punës. Duhet të kryhet vlerësim i rregullt i performancës së punonjësve. |
| Rezultatet e pritshme | Nga zbatimi i këtij projekti përfitojnë disa dhjetëra punonjes të Bashkisë së Tepelenës, duke patur mundësinë të rrisin aftësitë profesionale dhe t'i shërbejnë më mirë komunitetit. |
| Rendi prioritar | 3 |
| Qendrueshmeria e projektit | Menaxhimi logjistik i trajnimeve do të kryehet nga Bashkia e Tepelenës. |
| Aktivitetet e projektit | Kohëzgjatja e parashikuar: 3 vjet |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Nuk ka. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Faza e projekt-idesë. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti ka lindur jashtë kuadrit egzistues të planeve të mëparshme. |

| Titulli/Emertimi i Projektit | 9. Ndërtim qendre social-kulturore |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim social-kulturor-sportiv |
| Vendndodhja e projektit | Qyteti i Tepelenës |
| Buxheti total i projektit | 1.2 mln Eur (i ndarë në disa faza) |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 0.2 %. |
| Pershkrimi i projektit | Në qytetin e Tepelenës ndodhet vetëm një objekt me natyrë social-kulturore. Nevoja mund të konsiderohet si prioritare për cilësinë e jetesës në këtë zonë, veçanërisht për moshën e tretë. |
| Qellimi dhe objektivat | T'u garantohet banorëve të Tepelenës rritja e aksesit në aktivitete sociale, kulturore dhe sportive (si dhe mundësia e organizimit të tyre nga komuniteti). Qendra mund të plotësohet në një fazë të dytë edhe me terrene sportive. |
| Rezultatet e pritshme | Përfitojnë rreth 8-9 mijë banorë, të cilëve iu ofrohen mundësi pjesëmarrje dhe organizimi në aktivietete me natyre sociale, kulturore dhe sportive. |
| Rendi prioritar | 3 |
| Qendrueshmeria e projektit | Mirëmbajtja dhe menaxhimi i godinës do të kryehet nga Bashkia e Tepelenës. |
| Aktivitetet e projektit | Kohëzgjatja e parashikuar: 1.5-2 vjet (sipas fazave) |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Nuk ka VNM. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Faza e projekt-idesë. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është e planeve të investimeve kapitale të Bashkisë së Tepelenës. |

| Titulli/Emertimi i Projektit | 10. Menaxhim i integruar i mbetjeve urbane |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim infrastrukture |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia e Tepelenës |
| Buxheti total i projektit | 300 mijë Eur |
| Kontributi ne rastin e bashkefinancimit nga Qeveria Vendore | 0.5 %. |
| Pershkrimi i projektit | Mungon seleksionimi dhe segregimi i mbetjeve urbane. Mungojnë linjat e riciklimit eventual të mbetjeve urbane. |
| Qellimi dhe objektivat | T'u garantohet banorëve të Bashkisë së Tepelenës një shkallë më e lartë pastërtie dhe ruajtje shëndeti. Rritja e ndërgjegjësimit qytetar mbi mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit. Nisja e riciklimit në projekte pilotë.<br><br>Mund të shihet mundësia e bashkëpunimit me Bashkinë e Memaliajt për të njëjtin qëllim. |
| Rezultatet e pritshme | Përfitojnë rreth 15-16 mijë banorë, të cilëve iu ofrohet mjedis më i pastër e më i shëndetshëm jetese. |
| Rendi prioritar | 2 |
| Qendrueshmeria e projektit | Mirëmbajtja dhe menaxhimi i sistemit do të kryehet nga Bashkia e Tepelenës (eventualisht ndarja e kostove me Bashkinë e Memaliajt). |
| Aktivitetet e projektit | Kohëzgjatja e parashikuar: 1-2 vjet |
| Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis | Efekte pozitive mjedisore, zvogëlim i shkallës së ndotjes së mjedisit, në veçanti i lumit Vjosë. |
| Pershkrim per gatishmerine e projektit per zbatim. | Faza e projektit koncept. |
| Planifikimi vendor, ndervendor, kombetar | Projekti është pjesë e planeve të investimeve kapitale të Bashkisë së Tepelenës. |

# 7. Harta dhe fotografi




*Sistemi rrugor*




*Objektet arsimore*




*Monumente kulture*

*Kalaja e Ali Pashës dhe sheshi i qytetit pas rivitalizimit*